



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-9938 dt. 29.02. 2024



Bazuar në nenin 11,12,dhe 40 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/04, qershor 2008), te nenit 34, respektivisht neni 34.6 shkrinjat a dhe c, por edhe nenit 50 të Statutit të Komunës së Drenasit 01 nr.110-6904, i datës 24.09.2008, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.02.2024, miratoi këtë:

VENDIM

PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENZIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMUNAL AKSIONAR PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A

- I. Miratohet** vendimi për përcaktimin e kompenzimit RETROAKTIV nga data e emërimit të anëtarëve të Komisionit Komunal Aksionar të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e Komisionit Komunal Aksionar 02 Nr. 020-49438 i dt: 29.09.2022.
- II.** Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve do të kompenzohen, për çdo muaj sipas pagës minimale të përcaktuar të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A ku edhe shërbejnë.
- III.** Mjetet financiare për kompenzimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve do të merren nga Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A ku edhe shërbejnë.
- IV.** Ky vendim vlenë vetëm për anëtarët e Komisionit Komunal Aksionarë të zgjedhur nga Kuvendi i Komunës, ndërsa kompenzimin e Anëtarit në këtë Komision Komunal Aksionar të deleguar nga Kryetari i Komunës, këtij të fundit i rekomandohet këtë çështje ta rregulloj me Vendim të veçantë.
- V.** Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A
- VI.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

ARSYETIM

Vendimi për përcaktimin e kompenzimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A është marr për shkak të përgjegjësive të mëdha ligjore që ngarkojnë mbi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që shërbejnë në Komisionin Komunal të Aksionarëve Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A në pronësi të Komunës së Drenasit dhe duke marrur parasysh punën shtesë që këta persona janë të obliguar ta bëjnë në kuadër të këtyre përgjegjësive është vlerësuar që të njëjtit të kompenzohen ashtu si është paraparë në dispozitiv të këtij propozim-vendimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria

Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë

Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

DATA	26.03.2024
PËR/ZA/TO:	Z. Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllogocit
CC:	Z.Jeton Qela,UD.Sekretar i Përgjithshme/MAPL Znj.Leonita Shabani,zv.Sekretare e Përgjithshme/ME Z.Erblin Hetemi,U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Z.Xhevat Tafa,Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Znj.Vjosa Ahmetaj,Zyrtar e lartë për Monitorim të Komunave Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z.Valon Prebreza, Udhëheqës i NJPMNP-së
NGA/OD/FROM:	Arbërore Bernica-Hasani,analiste/NJPMNP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllogocit

I nderuar,

Në pajtim me Rregullore (qrk) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (qrk) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Ekonomisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullore (QRK) - Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, Njësia për Monitorim të Ndërmarrjeve Publike/NJPMNP, ka pranuar nga MAPL për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin 02 Nr.400 /01-9938 për përcaktimin e kompenzimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale “ Stacioni i Autobusëve” Sh.a Gllogocit, i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës .

Ministria e Ekonomisë / NJPMNP, ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë të aktit në fjalë, dhe :

KONFIRMON

Ligji nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike neni 5 paragrafi 2 rregullon “Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i

Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar " dhe

Me nenin 20.6 obligon "NP është përgjegjëse për pagimin e të gjithë kompensimit për drejtorët e saj. ..." që në kuptim të kësaj norme nënkupton kompensimin e Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjeve. Legjislacioni në fuqi për ndërmarrje publike shprehimisht si obligim për ndërmarrjen nuk e përcakton kompensimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve, përjashtimisht themelimit të këtij mekanizmi në përbërjen e tij.

Ministria e Ekonomisë, mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!